



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 209 Prot.

Tiranë, më datë 21.06.2024

VENDIM
Nr. 181, datë 21.06.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.06.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Projekti i ringritjes dhe restaurimit të minares së Xhamisë së Plumbit, Shkodër dhe rikualifikimi dhe restaurimi i zonës së mbrojtur të monumentit”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, Brenda Kufirit të Zonës Mbrojtëse të Monumentit, Bashkia Shkodër, me aplikues dhe zhvillues **Kadioglu Restorasyon Ve Mimarlik Sanayi Ve Ticaret Limited Sirketi**;
 2. Gjatë zbatimit të projektit për ringritjen e minares të merren masa konsoliduese shtesë për bazamentin;
 3. Subjekti aplikues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 4. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, datë 17.05.2018, neni 72, pika 1 dhe 2;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
 7. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI



KRYETAR
Blendi GONXHJA